



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Data ____/ ____/ 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Rikualifikimi i rrugëve Brisqe-Dajko-Ismail Qemali-Sul Bega-Mafuz Laze - Jordan Misja dhe Veri Gjata”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi 45233120-6 (punime ndërtimi për rrugë).

VLERA E FONDIT LIMIT :

36 553 402 (*tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e dy*) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes sipas shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.

2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) **vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros qëmund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me

anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
 - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
- d) *Akt Kolaudimi*
- e) *Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
- d) *Akti i Kolaudimit*

e) Faturat tatimore, Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP. 1 – A Punime Gërmimi ne toke

N.P. 4 – B Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P. 1 A (Punime gjurmimi në tokë)

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Duke analizuar preventivin e punimeve, liçensa e mësipërme përkon me punimet si 3.89/a Gjurmim dheu me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale gjerësi deri në 2 m tokë zak, kategoria III me shk në mjet në sasinë 250 m³ për rrugët Brisqe, Dajko, Ismail Qemali, Sul Bega dhe Mafuz Laze. , si dhe Gjurmim dheu me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale gjerësi deri në 2 m tokë zak, kategoria III me shk në mjet në sasinë 350 m³ për rrugët Jordan Misja dhe Veri Gjata

NP– 4 B (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet,

devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, **punime të mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Duke parë dhe vetë objektin e prokurimit i cili është “Rikualifikimi i rrugëve Brisqe-Dajko-Ismael Qemali-Sul Bega-Mafuz Laze - Jordan Misja dhe Veri Gjata” kjo kategori ndërtimi përkon dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me investimin që do të kryhet (e cila përshtatet me çdo zë të preventivit të punimeve).

Në vijim të objektit të prokurimit, qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është shtrimi i rrugëve të mësipërme duke i siguruar banorëve të zonës kushte më të mira jetesë.

Bazuar dhe nga preventive i punimeve ku përfshin punë të tilla si psh, shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm përhapur e ngjeshur me makineri, shtresë stabilizanti 10cm, shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe 7cm me makineri etj, të cilat janë në përputhje me licencën e mësipërme të kërkuar nga autoriteti kontraktor, dhe ku vlera e këtyre punimeve shkon rreth 26 milion lekë pa tvsh, njësia e prokurimit gjykon se përshtatet me klasifikimit B të lidhjes 4 nga 21 deri 50 milion lekë për këtë kategori punimesh.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh)

Referuar natyrës së punimeve të mësipërme për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NS 18 - A, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit 17 nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Ku kjo kategori kër kohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë për muajin e fundit, si më poshtë :

1) Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
2) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)
3) Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me

disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier ndërtimi, dhe Topograf, mekanik Inxhinier Ndërtimi (Profili infrastrukturë transporti, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

➤ **Inxhinier Ndërtimi 1 (një)**

Duke analizuar preventivin e punimeve, si dhe referuar objektin të prokurimit i cili është “Rikualifikimi i rrugëve Brisqe-Dajko-Ismail Qemali-Sul Bega-Mafuz Laze - Jordan Misja dhe Veri Gjata”, disponueshmëria nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të një inxhinier ndërtimi, si dhe mendimi i tij i specializuar ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, të kryejë një rrugë me standarte dhe punime sipas kushteve teknike, në përputhje me cilësinë që kërkon autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për një inxhinier ndërtimi, është një kërkesë në përputhje me preventivin e punimeve dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

➤ **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** **1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

➤ **Inxhinier Mjedisi** **1 (një)**

Është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit për punime gërmimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale.

Bazuar edhe në specifikimet teknike të hartuar, është parashikuar dhe mbrojtja e ambientit.

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjent lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë dhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mosplotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga mbikqyrësi i punimeve mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

Në seksionin “Pastrimi përfundimtar i zonës”.

Në përfundim të punës sa herë që është e aplikueshme sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa përfundimtare e kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi jepet miratimi nga mbikëqyrësi i punimeve.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf mbështetës, në listëpagesën e shoqërisë si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin :

- kontrate pune e vlefshme,
- diplomë,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- **Inxhinier Gjeoteknik**

Inxhinieri Gjeoteknik është i nevojshëm pasi ai do të verifikojë në terren kapacitetet mbajtëse të tokës dhe lidhjen e saj me tipin e zgjedhur të themelit dhe implementimin e mure buto betoni C12/15 si dhe shtruktura monolite betoni C20/25 si dhe Themel e xokol butobetoni C16/20, përse i përket ndërtimit të murit mbajtës të rrugës. Inxhinieri Gjeoteknik ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karierave të materialeve që do të përdoren për nënshtresat, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për e themelet e strukturës së betonit për murin mbajtës dhe për materialet e betoneve të tjera. Projekti zbatohet mbi formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e inxhinierit të sipërcituar. Bazuar në hartën e re sizmike ku i gjithë territori i Shqipërisë konsiderohet me sizmicitet të lartë, kujdesi dhe nevoja për staf të kualifikuar aq më tepër për stafin tekniko – inxhinierik si Inxhinieri Gjeoteknik është evidente. Pasi bëhet inspektimi në vend si dhe provat laboratorike, i propozohen mbikqyrësit të punimeve Mix – Design e Betoneve. Një rëndësi të madhe do të ketë prezenca e Ing. Gjeoteknik gjatë ndërtimit të shtresave të terreneve dhe themeleve të mureve mbajtës për shkak se terreni ku zbatohet kontrata (në një pjesë të saj) është terren jo i qendrueshëm.

Akoma më tej njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e kriterit të sipërcituar, duke lejuar disponueshmërinë e tij edhe në listëpagesat e shoqërisë, jo domosdoshmërisht si drejtues teknik i shoqërisë.

➤ **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rlevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses, duke marrë në konsideratë faktin se do të rikonstruktohen disa rrugë njëkohësisht

➤ Inxhinier Mekanik

1 (një)

Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për inxhinierin mekanik, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm është një kërkesë e nevojshme e parashikuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike. Sqarojmë se me këtë kërkesë nënkuptohet se operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar një inxhinier mekanik dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapacitetit të ofertuesve për personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, në kushtet kur prania e inxhinierit mekanik duhet të jetë e vazhdueshme në objekt dhe lidhet direkt me kapacitetin e shoqërisë për mbulimin e shërbimit të kërkuar me cilësi dhe në kohë të shpejtë.

Punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, përkojnë me kategorinë e licencës N.P 4 – A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramva, metro, pista aeroportuale. Në këtë kuptim Inxhinieri Mekanik është më se i mjaftueshëm për realizimin me sukses të objektit referuar vlerës së kontratës, kohëzgjatjes si dhe natyrës së punimeve të përcaktuara në preventive. Bazuar edhe në pikën 2.3.8 të DST ku parashikohet një numër i konsiderueshëm mjetesh dhe pajisjesh teknike, përcaktimi i kriterit për disponimin e një inxhinieri mekanik (për mirëmbajtjen e tyre me qëllim që puna mos të pezullohet asnjëher, është e domosdoshme për të mbikqyrur makineritë dhe mekanizmat që nevojiten për kryerjen e këtyre punimeve) e parë kjo nga objekti i kontratës, kompleksitetit, vlera e saj dhe preventivi i punimeve është në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e prokurimit.

Detyrat e inxhinierit mekanik, listohen si më poshtë :

- Inxhinieri mekanik është përgjegjës për montim, operim në eliminimin e defekteve, mirëmbajtje dhe riparim të makinave, komponentëve e tyre, pajisjeve mekanike, makinerive;
- Përgjegjës për makineri gjurmimi e ngarkimi dherash, makineri shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti;
- Përgatit vlerësime të detajuara të sasive dhe kostot e materialeve dhe punës së nevojshme, sipas specifikimeve të dhëna;
- Monitoron aspekte teknike për, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave dhe mekanizmave mekanike, objekteve dhe komponentëve për të siguruar performancë të kënaqshme dhe pajtueshmërinë me specifikimet dhe rregulloret;
- Siguron që pajisjet e punës të jenë në përputhje me specifikimet e projektit dhe me standardet e sigurisë.

2.3.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për të paktën muajin e fundit si staf teknik punonjësit si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	PUNONJËS
1	Shofer (drejtues kamioni)	4 (katër)
2	Automakinist	2 (dy)
3	Eskavatorist	3 (tre)
4	Punonjës asfalti	4 (katër)
5	Mekanik	1 (një)
6	Teknik ndërtimi	1 (një)
7	Hidraulik	1 (një)
8	Karpentier	2 (dy)
9	Betonues	2 (dy)
10	Hekurkthyes	1 (një)
11	Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë	1 (një)
	Totali 22 (njëzetë e dy) punonjës	

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .

Përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ***ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)***, kontrate pune e vlefshme.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR.

Në rastin kur mjetet e kërkuar më poshtë në pikën 2.3.8 janë me qera nuk është kusht që shoferët të jenë në listpagesën e shoqërisë, ata do të lejohen të plotësohen nga ofertuesit **edhe nëpërmjet kontraktimit për këtë objekt prokurimi.**

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime / kualifikime).

Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik apo çertifikata ekuivalente të tyre, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

Për automakinist 2 (dy) punonjës, , eskavatorist 3 (tre) punonjës, si dhe shofer 4 (katër) punonjës.

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet shtrimi i shtresës së asfaltobetonit me makineri autobitumatriçe dhe asfaltoshtuese, ku parashikohet shtrimi i rrugës me shtresë çakëlli në sasinë 7000 m² dhe shtresë stabilizanti në sasinë 7920 m², shtresë asfaltobetonit 7cm në sasi të mëdha dhe konkretisht 6600 m² për rrugët në Rikualifikimi i rrugëve Brisqe-Dajko-Ismail Qemali-Sul Bega-Mafuz Laze - Jordan Misja dhe Veri Gjata, si shtrimi i shtresës së asfaltobetonit me makineri autobitumatriçe dhe asfaltoshtuese, ku parashikohet shtrimi i rrugës me shtresë çakëlli në sasinë 2710 m² dhe shtresë stabilizanti në sasinë 2710 m², shtresë asfaltobetonit 7cm në sasi të mëdha dhe konkretisht 2168 m² për rrugët në Rikualifikimi i rrugëve Jordan Misja dhe Veri Gjata dhe garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë drejtues për makineri të rënda për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve si Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton 2 (dy) copë, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton 2 (dy) copë. Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1 deri në 3 ton 2 copë për transportimin e mallrave të mësipërm pranë kantierit të ndërtimit, Grejder 1 (një) copë, Asfaltoshtuese 1 (një) copë,

Autobitumatriçe 1 (një) copë, Rrul ngjeshës me peshë minimum 13 ton 1 (një) copë për ngjeshjen e çakullit, Rrul ngjeshës me peshë min 5 ton 1 (një) copë për ngjeshjen sistemin e asfaltit, Eskavatore me zinxhir (një) copë, Eskavator (mjet teknologjik me goma) 1 (një) copë, dhe Fadromë me goma 1 (një) copë, të nevojshëm për punimet e gërmimit dhe sistemit.

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përmbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimit në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.8 janë me qera.

Referuar volumit të punimeve, ku shtrimi i rrugëve në fshatin Fier Mimar është rreth 3 km me asfalt, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të arsyeshëm manovratorësh me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë

Për Mekanik 1 (një) person

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, kërkojnë një numër të konsiderueshëm për mjete dhe pajisjesh teknike (ku puna më e madhe do të kryhet nga këto mjete). Përcaktimi i kriterit për disponimin e 1 (një) mekaniku për mirëmbajtjen e tyre me qëllim që puna mos të pezullohet asnjëherë, është i domosdoshme për të mbikqyrur makineritë dhe mekanizmat që nevojiten për kryerjen e këtyre punimeve.

Për teknik ndërtimi 1 (një) person, **për Karpentier 2 (dy) persona** dhe **Betonues 2 (dy) persona** të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, nevojitet prezenca e tyre në kantier duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për sistemin e shtresës së çakullit dhe stabilizantit në gjithë gjatësinë e rrugës përpara ngjeshjes së saj me makineri,

Referuar preventivit të punimeve ku për dy objektet parashikohen punime si Mur betoni c12/15, themel e xoko betoni, struktura monolite betoni dhe bordure trotuari, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e këtyre zërave duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë. Duke qenë se investimi do të kryhet në një zonë kodrinore, dhe me mure mbajtës, qëllimi i autoriteti kontraktor është që zbatimin i punimeve të kryhet në përputhje me projektin dhe specifikimeve teknike duke garantuar këtë të fundit për cilësinë e punimeve dhe qëndrueshmërinë e saj.

Për Hekurkthyes 1 (një) person njësia e prokurimit gjykon se domosdoshmëria e këtij punonjësi është i nevojshëm për zbatimin e punimeve të parashikuar në preventiv si :

punime hekuri si 2.166 F.V Hekur betoni periodik Ø 6 – 10 mm

Si dhe 2.166/1a F.V Hekur betoni periodik Ø > 12 mm

- Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë

Njësia e prokurimit e gjykon së kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës, për shkak se garantimi i ekspertit së mbrojtjes e shëndetit në punë nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kriteri i mësipërm lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar edhe disponimin me çertifikata trajnime apo çertifikata ekuivalente të tyre, duke i shërbyer autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës, si dhe duke lehtësuar operatorët ekonomik ofertues në përmbushjen e këtij kriteri.

Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"* si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"*. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", është i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 30 (tridhjetë) punonjës, dhe të jenë në listëpagesën e shoqërisë në momentin e hapjes së tenderit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 4 (katër) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmërinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë/ose minimal të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, duke përcaktuar secilin punonjës me kualifikim e duhur, gjithçka në funksion të objektit të kontratës.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 30 (tridhjetë) punonjës të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent*
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- ISO 45001-2023 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), *ose ekuivalent.*
- ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, *ose ekuivalente.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të

operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

Kjo çertifikatë është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka

parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambjentit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose ekuivalentet e tyre**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo çertifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

➤ **ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, ose ekuivalente .**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, që është një çështje delikate dhe aktuale, me anë të së cilës garantohen mundësitë e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor të një subjekti me synim parandalimin e aksidenteve dhe trafikun në rrugë, në respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me sinjalistikën rrugore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve në menaxhimin e sigurisë të trafikut rrugor, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në këtë aspekt .

Standardi ndërkombëtar ISO 39001 është zhvilluar me qëllim për të ndihmuar në përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor. Ai cakton rregullat për një sistem menaxhimi i cili mund të implementohet nga çdo shoqëri e cila ndërton, projekton, administron apo përdor infrastrukturën rrugore.

ISO 39001 është zhvilluar me pjesëmarrjen e disa organizatave ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë, Banka Botërore apo Federata Ndërkombëtare e Rrugëve.

Ky standard përfshin kërkesat që kanë të bëjnë me zhvillimin e një politike në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor, ndërgjegjësimin e shoferëve, monitorimin e gjendjes teknike të automjeteve, përgatitjen për situata emergjente apo hetimin e aksidenteve në trafik.

Kjo certifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë sepse kemi të bëjmë me një Rikualifikim e disa rrugëve të brendshme, në fshatin Fier Mimar.

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine 1-3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Greider (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtuese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Eskavator (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Eskavatore me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Mini Dumper (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Mini ekskavator	në pronësi ose me qira	Cope 1
18	Aparat topogjeodezik	në pronësi ose me qira	Cope 1
19	Rrul gom hekur min 13 ton	Në pronësi ose me qira	Cope 1
20	Rrul hekur hekur min 5 ton	Në pronësi ose me qira	Cope 1

Për përmbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik si dhe certifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe taksat.*

- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij.(Për mjetet e deklaruar që transportojnë të klasifikuara të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqin, duhet të paraqitet certificate për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga

Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :

- Në lidhje me kamion vetëshkarkues 2 copë me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, dhe Kamion vetëshkarkues 2 copë me kapacitet mbajtës 10-15 ton njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen në volume të mëdha të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për transportimin e të gjitha materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht, për zërat shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm në sasinë 2710 m², shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 2710 m², shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm, me makineri në sasinë 2168 m² për rrugët Jordan Misja dhe Veri Gjata, si dhe transportin e materialeve për rrugët Brisqe, Dajko, Ismail Qemali, Sul Bega dhe Mafuz Laze për zërat shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm në sasinë 2710 m², shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 2710 m², shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm, me makineri në sasinë 2168 m² disponueshmëria e mjeteve të sipërcituar garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses.
- Në lidhje me Kamionçinë 2 copë me kapacitet mbajtës 1-3 ton copë 2, si dhe Kamion 1 copë me vinq, njësia e prokurimit sqaron se janë të nevojshëm për transportimin dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit në ato vende ku nuk mund të futen kamionat e mëdhenj me kapacitet mbajtës 10 dhe 20 ton. Një proces tjetër i rëndësishëm është transportimi i materialeve të ndërtimit F.V Hekur Betoni periodik etj.
- Në lidhje me, Rrul ngjeshës me peshë minimum 13 ton 1 copë, Rrul ngjeshës me peshë min 5 ton 1 copë, Grejder 1 copë dhe Mini Dumper (mjet teknologjik me goma) 1 copë.

Njësia e prokurimit sqaron se mjeti Grejder është i domosdoshme për hapjen dhe nivelimin e çakëllin, kurse mjeti Rrul ngjeshës me peshë min 15 ton është i nevojshëm për ngjeshjen e stabilizantit, granilit dhe çakullit. Duke qenë se nivelimi dhe ngjeshja e çakullit dhe stabilizantit duhet të kryhet në mënyrë perfekte, dhe pa çedime në gjithë gjatësinë e rrugës, nevojitet një rrul me peshë të mëdha të paktën 15 ton që puna të kryhet në përputhje me specifikimet teknike dhe sigurisë rrugore.

Si dhe rrul ngjeshës me peshë minimum 3 ton është i nevojshëm për ngjeshjen e asfaltobetonit, i cili kërkon një nivelim ngjeshës më pak të forte se çakulli me qëllim që mos të përhapet asfalti.

Duke qenë se investimi do të kryhet në një rrugë prej disa km, autoriteti kontraktor vlerëson numri i mjeteve i shërben qëllimit të këtij të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë

Në lidhje me Mini Dumper (mjet teknologjik me goma) 1 copë. Njësia e prokurimit gjykon se ky mjet është i përshtatshëm për mbushjen e bankinave ne rruge me stabilizant ne ato vende ku nuk mundet grejderi si makineri e madhe.

Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kotraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun e punimeve.

- Në lidhje me Asfaltoshtruese 1 copë, dhe Autobitumatrice 1 copë, njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për zërat e preventivit dhe më konkretisht :

Për zërin Shtresë asfaltobetonit me zall lavatriçe, 4 cm me makineri.

Autobitumatriçe është e nevojshme për hedhjen e prajmerit (që hap lëngun para shtrimit të asfaltit).

Asfaltoshtruesja është e nevojshme për shtrimin e asfaltit. Rrul asfalti hekuri 1 copë është i nevojshëm për ngjeshjen e asfaltit.

Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kotraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun dhe preventivin e punimeve.

- Në lidhje me Eskavator me goma (mjet teknologjik) 1 copë, Eskavator me zinxhinirë 1 copë, dhe Fadromë me goma 1 copë dhe Mini Fadrome (mjet teknologjik me goma) kërkohet për gjërmime dhe mbushje të shtresave rrugore dhe mbeturinave. Duke qenë se të gjitha rrugat parashikohet gjërmime në sasi 250 m³ dhe 350 m³ për të gjitha rrugët, ku do të punohet në disa drejtime njëkohësisht, NJP gjykon se kërkesa e mësipërme është

në përputhje me objektin e kontratës. Në lidhje me minifadromëm, AK gjykon se disponueshmëria e tij lidhet drejtëpërdrejtë me gërmimet në ato vende ku nuk mund të gërmojnë mjetet e mëdha si më sipër

- Në lidhje me Betoniere, Autobot uji, prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për përgatitje llaçi dhe çimento për muret buto betoni dhe themel xokol butobetoni, etj, të cilat janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve të murit mbajtës.
- Në lidhje me Rimorkiator, NJP gjykon se kërkesa e mësipërme është e domosdoshme për transportimin e mjeteve me zinxhira pranë kantierit të ndërtimit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në pronësi/me qira ose kontratë furnizimi :

- Impiant Prodhim asfaltobetoni me QKL
- Nyje inerte me QKL

Lidhur me kërkesën për Impiant për prodhimin e asfaltit me QKL si dhe Nyje inerte me QKL ku ofertuesit duhet ti disponojnë në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, njësia e prokurimit argumenton se :

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) impiant për prodhimin e asfaltit, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik, duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik .

Në preventin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime si Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7 cm me makineri, në sasinë 6600 m2 për rrugët Rikualifikimi i rrugëve Brisqe-Dajko-Ismail Qemali-Sul Bega-Mafuz Laze – dhe 2168 m2 Jordan Misja dhe Veri Gjata.

Si dhe punime si punime si shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm në sasinë 2710 m2, shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 2710 m2, shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm, me makineri në sasinë 2168 m2 për rrugët Jordan Misja dhe Veri Gjata, si dhe transportin e materialeve për rrugët Brisqe, Dajko, Ismail Qemali, Sul Bega dhe Mafuz Laze për zërat shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm në sasinë 2710 m2, shtresë stabilizanti 10cm në sasinë 2710 m2.

Duke pare volume e mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- Licensë të shoqërisë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B”. “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

- Licensë të shoqërisë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B”. “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme”.

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3, si dhe Transport material ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km në sasinë 2610 m2), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “ Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, parashikohet se “ Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër, konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivti, kërkesa e autoritetit kontraktor për

licencim është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, pasi krahas punimeve të gërmimit, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e mbeteve urbane, transportin e dherave dhe inerteve, i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara .

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

çmimi ☐ pikët ☐

Çmimi

pikët 60

Grafiku i punimeve dhe metodologjia

pikët 25

Stafi / Organizimi i Kompanisë

pikët 15

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b ,3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [60 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{mink1}	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
P_{maxk1}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

2. Grafiku i punimeve dhe metodologjia [25 pikë]

Operatori ekonomik ofertues mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (jo më shumë se 1 vit). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a) Grafiku i punimeve të Kontratës [15 pikë]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizën e makinerive që do angazhojë për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{mink2a}	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
P_{maxk2a}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2a}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b) Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

- Faktorët favorizues:

Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm.

- Pajisje inovative:

Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit.

Metodologji punimesh: Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 4 gërma b) dhe pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024), si dhe me gërmën b) të pikës 2 të nenit 87 të Ligjit Nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se ;

Neni 87 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;
- b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

Kontraktori duhet të përgatisë Metodologjinë e Punëve për të plotësuar kërkesat e zbatimit të projektit në kohën, sasinë dhe cilësinë e duhur. Metodologjia që ndiqet për realizimin e punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton, gjithashtu, detyrat dhe strukturën organizative të grupit të zbatimit të punimeve. Përmban menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit.

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik ofertues duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [15 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [2 pikë]
- II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [2 pikë]
- III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [3 pikë]

Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [5 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 4 gërma b) dhe pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024), si dhe me gërmën b) të pikës 2 të nenit 87 të Ligjit Nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se ;

Neni 87 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

- c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e

mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

Duke marrë në konsideratë faktin që tek rrugët Jordan Misja dhe Veri Gjata është kostatuar një segment prej 15 ml i cili janë verejtur shkarje si rezultat i veprimit të ujrave sipërfaqësor dhe ku është sfidë me vete elemini i tyre, me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor për qendrueshmërinë e rrugëve që do të ketë në të ardhmen si dhe zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, është e nevojshme disponimi nga ana e ofertuesve të stafit dhe organizmit të kompanisë si dhe dëshmitë që këta të fundit kanë për stafin e kualifikuar për punime të ngjashme.

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

- Çertifikatat ISO e kërkuar sipas DST.

Argumentim

Referuar karakteristikave që kanë certifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, lidhur me standartet, si dhe mënyrës më anë të së cilës subjektet certifikohen nga trupat e akredituara të certifikimit, njësia e prokurimit gjykon se certifikimet sipas standarteve ISO 9001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë) ose *eikuvalente*; ISO 14001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit) ose *eikuvalente* dhe ISO 39001:2012 mbi

“Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, ose ekuivalente, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent, janë çertifikime ekskluzive, tërësisht individuale dhe që lidhen ngushtë vetëm me plotësimin e standarteve mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, të subjektit i cili certifikohet, pasi i është nënshtruar auditimeve përkatëse nga trupat certifikuese. Pra, përsa kohë certifikimet mbi standartet e mësipërme, janë tërësisht personale të subjekteve, AK vlerëson se, certifikimi lidhur me plotësimin e standarteve nga një subjekt nuk mund të garantojë se subjektet e tjera që mbështetet i plotësojnë këto standarte, pavarësisht tipologjisë të objektit të veprimtarisë së subjektit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT